

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr. 05/L-150, si dhe nenin 4, paragrafi 3, dhe nenin 75, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet, Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2024, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR KËRKESAT E MBAJTJES SË RREZIKUT DHE MBULIMIT PËRMES RISIGURIMIT**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është caktimi i kërkesave që siguruesit duhet të mbajnë dhe përcjellin në lidhje me obligimet e tyre për të siguruar te një risigurues, rrezikun e siguruar, që tejkalon kufijtë maksimal të mbulimit siç është përcaktuar nga kjo rregullore.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit dhe degët e sigurueseve të jashtëm të licencuar nga BQK-ja për të vepruar në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-45 për sigurimet (me tutje Ligji për sigurimet), ose sipas përkufizimeve në vijim, për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - 1.1. **Viti financiar** – nënkupton periudhën dymbëdhjetë mujore, e cila fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Për një sigurues të ri të licencuar, viti fillestar financiar fillon në datën e licencimit të tyre dhe përfundon më 31 dhjetor të vitit kur ka marrë licencën e parë. Pas kësaj, viti financiar do të jetë nga 1 janari deri më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik;
  - 1.2. **Rasti i siguruar** – nënkupton një rast i cili nëse ndodhë mund të shkaktojë sigurimin e të drejtës për të marrë zhdëmtim nga sigurimi;
  - 1.3. **Cedim** – nënkupton kalimin e një pjese të rrezikut të siguruar nga një sigurues te një risigurues;
  - 1.4. **Risigurim** – nënkupton cedimin e rreziqeve të caktuara nga një sigurues te një risigurues;
  - 1.5. **Risigurues** – nënkupton personin juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari risigurimi sipas përcaktimeve të Ligjit për Sigurimet;
  - 1.6. **Mbajtje e rrezikut** – nënkupton shumën apo pjesën e shumës së siguruar nga siguruesi, e cila nuk është e risiguar (nuk është ceduar te risiguruesi);

- 1.7. **Marrëveshjet e fshehura** – nënkupton marrëveshjet formale ose joformale (me gojë ose me shkrim) që nuk janë pjesë e kontratës së risigurimit por që në thelb modifikojnë një marrëveshje risigurimi ose ndryshojnë transferimin e qenësishëm të rrezikut të sigurimit në kontratë;
  - 1.8. **Shuma e siguruar** – nënkupton vlerën, për të cilën janë pajtuar siguruesi dhe i siguruari apo që mund të jetë përcaktuar ndryshe me legjislacionin në fuqi dhe që përcakton kufirin e përgjegjësisë së siguruesit kundrejt të siguarit.
2. Për qëllime të kësaj rregulloreje me termin sigurues kuptohet edhe dega e siguruesit të jashtëm.

### **Neni 3**

#### **Mbajta e rrezikut për siguruesit e licencuar**

1. Siguruesit e licencuar nuk duhet të mbajnë rrezik më të lartë se 10% e kapitalit të tyre themeltar, për një rast të siguruar. Për rreziqet që e tejkalojnë nivelin maksimal të mbajtjes së rrezikut të përcaktuar ligjor prej 10%, siguruesi është i obliguar që të siguroj mbulesë risiguruese.
2. Siguruesit duhet të lidhin kontratë risigurimi vetëm me risiguruesit të cilët janë të licencuar për kryerjen e veprimtarive të risigurimit dhe të cilët janë subjekt i mbikëqyrjes në vendin ku risiguruesi e ka selinë qendrore.
3. Secili sigurues duhet të monitorojë ekspozimin ndaj akumulimit të rreziqeve, si dhe ekspozimin ndaj rasteve të katastrofave natyrore dhe në raport me këtë, të mbajë mbulesë risiguruese adekuate.
4. Kalkulimet për kufizimet sipas këtij neni, do të bazohen në pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe të dorëzuara në BQK.
5. BQK-ja mund të kërkojë risigurim tjetër ose shtesë nëse përcakton se kjo do të mbrojë interesat e policëmbajtësve.

### **Neni 4**

#### **Blerja e mbulimit nga risigurimi**

1. Të gjithë siguruesit e licencuar duhet të blejnë mbulimin e nevojshëm të risigurimit për dallimin në mes të rrezikut që është marrë në sigurim dhe nivelit maksimal të mbajtjes së rrezikut.
2. Mbulimi i risigurimit duhet të jetë aktiv jo më vonë se me 1 janar për vitin e ardhshëm financiar dhe do të përmbledhet e do të dorëzohet në planin përmbledhës të risigurimit, si dhe do të azhurnohet gjatë vitit kalendarik nëse pëson ndryshime.
3. Nuk lejohet që rreziku i marrë në sigurim të bëhet pa mbulim të plotë të risigurimit. Në rast se zbulohet se rreziku i marrë në sigurim është bërë pa mbulim të plotë të risigurimit, atëherë siguruesi do t'i nënshtrohet masave ndëshkimore sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.
4. Siguruesi obligohet që brenda afatit prej dhjetë ditëve nga dita e zbulimit të mos posedimit të mbulimit të plotë ri sigurues, të blejë mbulimin e plotë të ri sigurimit për rrezikun e marrë në sigurim.
5. Për kontratat të risigurimit, siguruesit duhet të blejnë mbulimin e nevojshëm të risigurimit nga risiguruesit, të cilët duhet të kenë klasifikim jo më të dobët se vlerësimi BBB nga Standard & Poor's ose ekuivalentët e saj nga Fitch dhe Moody's, apo ekuivalentet e saj nga agjencionet e tjera

të klasifikimit (rejtingut), të pranueshme për BQK-në. Klasifikimi i risiguruesit nga një prej agjencive përkatëse klasifikuese sipas këtij paragrafi, duhet të jetë i përcaktuar jo më herët se 18 muaj para datës së hyrjes në fuqi të kontratës së risigurimit.

6. Rreziku i dorëzuar në risigurim duhet të përputhet me rrezikun e marrë në policën adekuate, gjegjësisht policat adekuate për sigurim dhe/apo risigurim aktiv duke respektuar parimin e vijimësisë.
7. Kontrata e risigurimit duhet siguroj shlyerjen e të gjitha detyrimeve kontraktuale që rrjedhin nga kontratat e sigurimit edhe në rastet e falimentimit, pa-aftësisë paguese apo vështirësive tjera financiare të siguruesit. Kontrata e risigurimit nuk duhet të përmbajë klauzolë përmes së cilës i garantohet e drejta risiguruesit që të përfundoj/ndërpresë kontratën si rezultat i rrezikut të insolencës apo falimentimit të siguruesit.
8. Kontratat e risigurimit nuk duhet të përmbajë transferim të dukshëm të rrezikut financiar, në vend të rrezikut sigurues apo të klasifikohen si kontrata të risigurimit të kufizuar/financues (ang: finite reinsurance).
9. Kontratat e risigurimit nuk duhet të përmbajë klauzola të cilat i mundësojnë risiguruesit përfitim të drejtpërdrejt të rrjedhës së parasë në çdo rrethanë përmes kushteve specifike të cilat kufizojnë rrezikun e marrë në kontratën e risigurimit.
10. Kontratat e risigurimit nuk duhet të përmbajë marrëveshje të fshehura.
11. Çdo rrezik i cili transferohet në tërësi (100%) te risiguruesi nga siguruesi dhe nuk është i përfshirë në kuadër të marrëveshjeve të rregullta, duhet të jetë i mbështetur me marrëveshje individuale të shkruar, në kuadër të së cilës në mënyrë specifike përshkruhen mbulimet, përjashtimet dhe elementet tjera përcjellëse të rrezikut të transferuar.
12. Kontrata ndërmjet siguruesit dhe risiguruesit nuk duhet të përmbajë dispozita përmes të cilave në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi i garantohet fitim palëve kontraktuese.

## **Neni 5**

### **Dorëzimi i programit të risigurimit**

1. Siguruesit duhet të finalizojnë kalkulimet e tyre për kufij të mbajtjes së rrezikut dhe të përgatitin programin e risigurimit të bazuar në biznes-planin e tyre për vitin e ardhshëm kalendarik dhe do ta dorëzojë atë për shqyrtim në BQK, jo më vonë se 60 ditë kalendarike para mbylljes së vitit financiar.
2. Programi i risigurimit para se të dorëzohet në BQK, duhet të aprovohet nga Bordi i drejtorëve të Siguruesit.
3. Siguruesit duhet të hartojnë dhe implementojnë programin e tyre të risigurimit, varësisht nga struktura e portofolit së tyre të sigurimit, si dhe të përcaktojnë dhe konfirmojnë që programi dhe marrëveshjet e tyre të risigurimit ofrojnë mbulim të mjaftueshëm për rreziqet specifike dhe agregate.
4. Programi i risigurimit duhet të përmbajë së paku zërat si në vijim:
  - 4.1. kalkulimin e agregatit total të rreziqeve për secilën klasë të mbajtur të sigurimeve;

- 4.2. tabelën e mbulimit maksimal, të krijuar në bazë të llogaritjeve të referuara në nënparagrafin 4.1. të këtij paragrafi;
  - 4.3. procedurat, bazat dhe kriteret për përcaktimin e probabilitetit më të lartë të humbjeve që mund të rezultojnë nga ndodhja e një rasti të vetëm, nga një rrezik i caktuar i pranuar;
  - 4.4. emrat e risiguruesve dhe përqindjet e tyre të pjesëmarrjes në pranimin e rreziqeve; dhe
  - 4.5. termet specifike të kontratave.
5. BQK-ja pas shqyrtimit të programit të risigurimit, para fillimit të vitit kalendarik mund ta refuzoj atë nëse vlerëson se i njëjti nuk përmbush kriteret e caktuara me ligjin për sigurimet dhe këtë rregullore.
  6. Në rastet nga paragrafi 2 dhe 5 i këtij neni, BQK-ja do të kërkojë nga siguruesi t'i bëjë përmirësimet e nevojshme në mënyrë, që programi i risigurimit të jetë në pajtim me kërkesat ligjore dhe rregullative.
  7. Kalkulim i mbajtjes së rrezikut do të azhurnohet çdo tre muaj dhe do të dorëzohet në BQK, duke u bazuar në shënimet e fundit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i tremujorit.
  8. Bordi i drejtorëve dhe kryeshefi ekzekutiv i siguruesit do të jenë drejtpërdrejt përgjegjës për përmbushjen e kërkesave të kësaj rregulloreje.
  9. BQK-ja mund të nxjerrë udhëzime shtesë për zbatimin e kësaj rregulloreje.

## **Neni 6**

### **Mënyra dhe afatet e raportimit**

1. Siguruesit janë të detyruar të raportojnë në BQK programin e risigurimit si dhe të gjitha të dhënat që rrjedhin nga kontratat e risigurimit në përputhje me format dhe udhëzimet e përcaktuara nga BQK.
2. Siguruesit janë të detyruar të raportojnë në BQK në formë elektronike kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni brenda një afati 30 ditor nga mbarimi i tremujorit si në vijim:
  - 2.1. gjendjen deri me 31 mars për tremujorin e parë të vitit përkatës;
  - 2.2. gjendjen deri me 30 qershor për tremujorin e dytë të vitit përkatës;
  - 2.3. gjendjen deri me 30 shtator për tremujorin e tretë të vitit përkatës;
  - 2.4. gjendjen deri me 31 dhjetor për tremujorin e katërt të vitit përkatës.
3. Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, siguruesit janë të obliguar që të përgatitin dhe të raportojnë në BQK një raport lidhur me të dhënat e risigurimit edhe pas auditimit të pasqyrave financiare.
4. BQK nxjerr udhëzime përkatëse dhe përcakton forma të raportimit në zbatim të kësaj rregulloreje.

## **Neni 7**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje, do të jetë subjekt i masave administrative dhe dënimeve me gjobë siç përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 05/L-045 për sigurimet.

## **Neni 8**

### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes risigurimit, e datës 31 mars 2016.

## **Neni 9**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 30 qershor 2024.

Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës